

**2009-2010**

**PLANI MESIMOR VJETOR**

**Grupi i III<sup>të</sup>**

### **GJENDJA E GRUPIT DHE E FËMIJËVE**

- ☞ Fëmijë të regjistruar për herë të parë vijnë nga grupi i dytë :.....
- ☞ Femra:....
- ☞ Meshkuj:.....
- ☞ Të gjithë të vaksinuar :.....
- ☞ Gjendja shëndetësore e mirë :.....
- ☞ Fëmijë me probleme të zhvillimit mendor :....

### **ARSIMI I PRINDËRVE**

1-Arsimi i lartë :.....

2-Arsimi i mesëm :.....

3-Arsimi 9-vjeçar :.....

Fëmijët në grup janë nga të gjitha krahinat si rezultat i ndryshimeve demagogjike të kohëve të fundit ....

### **GJENDJA E MJEDISËT NË KOPËSHT**

Grupi ka hapësirë në :Ë përshtatshëm për rritjen e edukimit dhe argëtimin e fëmijëve ,me dritë ,ujë ,ngrohje dhe freski .Grupi ka hapësirë për mësim ,lojë kalitje dhe çlodhje me ambiente për zhvishje .

Është i pajisur me shumë lodra dhe mjete mësimore didaktike për një mësim normal dhe me cilësi .

Për të realizuar me sukses dhe cilësi STANDARTET NË ARSIMIN PARA SHKOLLOR me mjediset e grupit janë ngritur :

1. QENDRA MATEMATIKE
2. QENDRA LEXIM SHKRIM
3. QENDRA ARIT
4. QENDRA MANIPULIMEVE
5. QENDRA ARTI DRAMATIK
6. QENDRA SHKENCES
7. QENDRA MUZIKES

### **PLANË I VEPRIMTARËVE VJETORE**

PLANË VJETOR Ë HARTUAR PASQYRON REALIZIMIN E PIKSYNIMEVE PËR TË ARRITUR TEK OBJEKTIVAT THEMELORE TË REALIZUESHME .

KY PLAN E SHTRËN VEPRIMTARËNË NË KËTO FUSHA:

1-EDUKIM QYTETAR

2-ZHVILLIMI Ë GJUHËS DHE ELEMENTET E SHKRIMIT

**OBJEKTIVAT SIPAS FUSHAVE TË ZHVILLIMIT QË DUHET TË ARRIJNË FËMIJËT  
GJATË NJË VITI SHKOLLOR 2009-2010**

**Synimi**

Të pajisen fëmijët e grupmoshës 5-6 vjeç me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë më të domosdoshme, duke iu krijuar të gjithëve shanse të barabarta edukimi dhe trajtimi.

**Objektivat**

*Zhvillimi gjuhësor*

Fëmija të jetë i aftë:

1. Të përdorë shpesh fjali dhe të bëjnë pyetje të thjeshta me anë të gjesteve.
2. Të përdorë intonacion e ritëm të qartë gjatë komunikimit, i cili të jetë i kuptueshëm për të tjerët.
3. Të pyesë për shumë gjëra që ndodhin e të japë edhe shpjegime.
4. Të dëgjojë histori dhe të marrë pjesë në biseda duke përqendruar vëmendjen.
5. Të marrë pjesë dhe të ketë iniciativë për të diskutuar jo vetëm me moshatarët, por dhe më të rriturit.
6. Të vëzhgojë rregullat e diskutimit dhe t'i zbatojë ato edhe si folës, por dhe si dëgjues.
7. Të formulojë mendime të qarta duke përdorur fjali të sakta që shprehin ide.
8. Të përdorë intonacion të ndryshëm, duke strukturuar fjalitë dhe idetë e tij kur flet.
9. Të flasë rreth karaktereve, vendit dhe ngjarjeve që lidhen me përmbajtjen e pjesës që dëgjon ose ia lexojnë.
10. Të tregojë respekt për të tjerë kur ata flasin apo dhe kur flet vetë.
11. Të përdorë të folurit në bisedë, duke i dhënë një kuptim të ri një objekti ose një veprimi të caktuar.
12. Të përdorë të folurit në bisedë duke i lidhur idetë e tij, por dhe duke parashikuar se çfarë mund të ndodhë më tej.
13. Të përdorë të folurit në bisedë për të risjellë në kujtesë dhe për të rjetuar përvojat jetësore që ka kaluar.
14. Të përmbledhë përvojat personale duke i lidhur me materialet që i lexohen ose që i lexon vetë.
15. Të tregojë me saktësi se secilës shkronjë i korrespondon një tingull.
16. Të shfaqë një të kuptuar të qartë në përdorimin e rimës.
17. Të përdorë qartë rimën, si dhe shumë tinguj në fjalët e folura.
18. Të thotë secilin tingull duke e lidhur saktë me shkronjën.
19. Të identifikojë saktë në një fjalë ose në një pikturë të njëjtën shkronjë ose tingull gjuhësor.
20. Të demonstrojë një të kuptuar të qartë se si një material është paraqitur i shkruar dhe si mund të lexohet.
21. Të mbajë një material të shkruar në pozicionin e saktë për të lexuar.
22. Të identifikojë saktë faqen e parë të një libri, si dhe titullin e tij.
23. Të thotë secilën shkronjë duke ndjekur me gisht materialin e shkruar nga e djathta në të majtë të faqes.
24. Të identifikojë qartë hapësirat midis fjalëve, si dhe përbërjen e fjalëve si një kombinim i shkronjave.
25. Të çiftojë me zë në një tekst të shkruar, duke shoqëruar shkronjat, rrokjet, fjalët dhe fjalitë.
26. Të shpjegojë se çfarë informacioni mund të marrë nga një material i shkruar.
27. Të identifikojë firmat, logot, simbolet e njëjta në një material.
28. Të lexojë dhe shpjegojë të shkruarit dhe të vizatuarit e tij.
29. Të shkruajë saktë emrin e tij dhe të pjesëtarëve të familjes me shkronja kapitale.
30. Të përdorë mirë ngjyrat, lapsin e stilolapsin në të shkruar.

## "MEHMET AKIF" TËRANA

(GRUPI III<sup>të</sup>)

31. Të identifikojë lehtë materialet që përdoren për të shkruar.
32. Të demonstrojë me anë të pikturës që bën sekuenca të ngjarjeve që ka dëgjuar ose parë.
33. Të klasifikojë shkronjat, pikturat dhe objektet.
34. Të identifikojë qartë shkronjat kapitale nga ato të dorës.
35. Të respektojë gjatë të shkruarit vijat, hapësirat dhe linjën që duhet të ndjekë duke demonstruar një vetëkontroll motorik.
36. Të shfaqë dëshirë të vazhdueshme për të shkruar shkronjat e mëdha dhe të vogla të dorës, si dhe ato kapitale.

*Zhvillimi matematikor*

Fëmija të jetë i aftë të:

1. Tw numëroje të paktën deri në 20.
2. Të lexojë numërorët të paktën deri në 20.
3. Të shkruajë numërorët të paktën deri në 10.
4. Të krahasojë dy numra deri në 10, bazuar në dy grupe sendesh.
5. Të renditë në rritje të paktën deri në 20 dhe në zbritje duke filluar nga 10.
6. Të mbledhë deri në 10 dy numra natyrorë duke bashkuar dy grupe sendesh.
7. Të zbresë dy numra natyrorë duke e konkretizuar me grupe sendesh (p.sh. 7 mollë heqim 2 mollë, mbeten 5 mollë).
8. Të zgjidhë problema të thjeshta me një veprim, me mbledhje dhe zbritje, në situata konkrete që dalin nga jeta e përditshme e fëmijëve.
9. Të emërtojë figurat gjeometrike dydimensionale: katrori, trekëndori, rrethori, drejtkëndori.
10. Të krijojë figurat gjeometrike dydimensionale: katrori, trekëndori, rrethori e drejtkëndori nëpërmjet vizatimit me dorë të lirë, prerjes më gërhshërë apo palosjes duke përdorur materiale të ndryshme (fije shkrepëses, shkopinj etj).
11. Të gjejë forma ose pjesë të tyre, të ngjashme me figurat gjeometrike dydimensionale dhe trupat gjeometrikë tredimensionalë, që gjenden në mjedisin rrethues.
12. Të emërtojë trupat gjeometrikë tredimensionalë: kubi, kuboidi, cilindri, sfera.
13. Të përshkruajë vendndodhjen e një objekti duke iu referuar një objekti tjetër ose vetes së tij dhe duke përdorur fjalë të jetës së përditshme (para - pas; poshtë – lart; mbi – nën; afër – larg etj).
14. Të lëvizë në drejtime të caktuara duke u orientuar nga fjalët (para, drejt, majtas, djathtas, prapa derës, afër karriges, nën tavolinë etj).
15. Të kryejë matje të gjatësive me njësi jostandarde (hapi, pëllëmba, libri, shirita letre etj).
16. Të krahasojë masat e sendeve duke përdorur njësi jostandarde (mollë, laps, libra, lodra, peshore lodër etj), si dhe shprehjet: "më i rëndë se", "po aq i rëndë", "më i lehtë se...". (P.sh: Çanta është më e rëndë se molla etj.).
17. Të krahasojë gjatësitë e sendeve, duke përdorur terminologjitë: "më i gjatë se...", "po aq i gjatë sa...", "më i shkurtër se...".
18. Të krahasojë sipas madhësisë sende dhe objekte duke përdorur fjalët: më i madh, më i vogël, më i lartë, më i ulët etj.
19. Të klasifikojë sendet sipas gjatësisë, peshës, volumit dhe lartësisë.
20. Të renditë sendet dhe objektet sipas gjatësisë, peshës, volumit dhe lartësisë.
21. Të renditë fjalët që tregojnë kohën sipas rrjedhës së saj: mëngjes, drekë, pasdite, mbrëmje.
22. Të renditin ditët e javës, muajt e vitit, si dhe stinët.

**“MEHMET AKIF ” TËRANA**

**(GRUPI III<sup>të</sup>)**

23. Të renditë ngjarje të ndryshme të një dite (ardhja në kopsht, ngrënia e mëngjesit, loja etj.).
24. Të shoqërojnë veprimet me fjalët që tregojnë kohën e veprimit: në mëngjes, në drekë, pasdite, në mbrëmje, natën, dje, sot, nesër etj.
25. Të tregojë ngjarje që lidhen me ditë të caktuara të javës, muajve dhe stinëve (P.sh: “Të hënë shohim filmin në kopsht”, “Në maj kam ditëlindjen” etj).
26. Të vazhdojë renditjen duke zbuluar rregullin në modelin e dhënë sipas formës, ngjyrës, madhësisë, volumit, peshës, gjatësisë.
27. Të klasifikojnë grupe sendesh sipas një ose më shumë cilësive të përbashkëta.
28. Të krahasojnë një model me një tjetër, sipas rregullit të ndërtimit të tyre (p.sh. ndryshimi në ngjyrë, në renditjen e formave, në renditjen e madhësisë, peshave, gjatësisë etj).
29. Të grumbullojnë të dhëna për veten e tyre, shokët dhe nga mjedisi rrethues (10 fëmijë e kanë ditëlindjen në korrik, 3 në qershor, 2 në maj etj.).
30. Të lexojnë tabelat e grumbullimit të të dhënave (p.sh. për javën: 3 ditë me shi, 2 ditë me re, 1 ditë me diell dhe 1 ditë me erë).

***Zhvillimi shkencor***

Fëmijët të jenë të aftë:

1. Të mësohen me vëzhgimin.
2. Të vëzhgojnë dhe të kuptojnë se qeniet njerëzore kanë shqisa dhe ndjesi, duke përfshirë të parin, nuhatjen, dëgjimin, prekjen, shijen.
3. Të vëzhgojnë dhe të kuptojnë që magnetet veprojnë në disa materiale, duke i bërë ato të lëvizin pa i prekur dhe kanë një zbatim e përdorim të gjerë.
4. Të vëzhgojnë dhe të kuptojnë që objektet mund të përshkruhen në bazë të veçorive të tyre fizike.
5. Të vëzhgojnë dhe të kuptojnë që uji ka veti të caktuara.
6. Të kuptojë nevojat bazë dhe proceset jetësore të bimëve dhe të kafshëve.
7. Të vëzhgojë dhe të kuptojë që hija krijohet atëherë kur drita është e bllokuar nga një objekt.
8. Të vëzhgojë dhe të kuptojë shembuj të thjeshtë apo dhe prototipa nga jeta e tij e përditshme.
9. Të vëzhgojë dhe të kuptojë se ndryshimet ndodhin vazhdimisht dhe shpejtësia e tyre mund të jetë e ndryshme, si: ngadalë, shpejt.
10. Të vëzhgojë dhe të kuptojë që materialet mund ripërdoren, të ruhen dhe të konservohen.

***Zhvillimi social dhe personal***

Fëmija të jetë i aftë të:

1. Të rritë pavarësinë duke treguar kujdes për zgjedhjen e veprimtarive dhe funksionimin e tyre.
2. Të jetë i afrueshëm me të tjerët dhe të bashkëpunojë me ta.
3. Të shfaqë ndjenjën e përkatësisë.
4. Të tregojë kujdes dhe shqetësim për veten.
5. Të flasë lirshëm për shtëpinë dhe komunitetin.
6. Të aftësohen të krijojnë marrëdhënie me fëmijët e tjerë të grupit.
7. Të demonstrojnë fleksibilitet dhe të përshtatë sjelljen në situata të ndryshme sociale.
8. Të tregojë kujdes dhe shqetësim për të tjerët, për gjallesat dhe mjedisin.
9. Të vetëdijësohet për kufizimet dhe të përshtatë sjelljen e tij.
10. Të ndër marrë iniciativa duke realizuar kërkesat përkatëse.
11. Të shfaqë ndjenjën e përkatësisë por edhe të bashkëpunimit si një anëtar i komuniteteve të ndryshme (për shembull në familje, në kopsht etj)

***Edukimi artistik***

Fëmijët të jenë të aftë të:

1. Të tregojnë që pjesët teatrore janë situata ku ata marrin pjesë dhe luajnë.
2. Të punojnë në grup me të tjerët gjatë dramatizimit të një pjese teatrore.
3. Të përdorin *imagjinatën* gjatë lojës teatrore.
4. Të tregojnë që prezantimi skenik zhvillohet nga disa *personazhe* që quhen *aktorë*.
5. Të tregojnë se një prezantim skenik përfshin karaktere (personazhe) kryesore dhe të përgjithshme.
6. Të shpjegojnë se *kostumet, tingujt dhe muzika* mund të jenë pjesë e mjaft prezantimeve skenike që ata shikojnë, p.sh. “*Kecat dhe ujku*”, “*Borëbardha*” etj.
7. Të përshkruajnë pjesët që luajnë në mjedisin e tyre.
8. Të sjellin shembuj të pjesëve teatrore që shikojnë.
9. Të përshkruajnë pjesët që luajnë në mjedisin e tyre.
10. Të sjellin shembuj të pjesëve teatrale (për fëmijë) që shikojnë në shtëpi, komunitet etj.
11. Të shpjegojnë efektet që krijon një pjesë teatrore tek ata.
12. Të marrin pjesë në diskutimet rreth një përvoje që ata kanë në interpretimin e një pjese teatrore.
13. Të tregojnë se sa i besueshëm është prezantimi i një pjese teatrore.
14. Të dallojnë *tingujt natyralë* dhe *muzikorë*.
15. Të përdorin me fjalët e veta *tinguj* e *zhurma*, duke përmendur disa nga *karakteristikat dhe cilësitë e tyre*.
16. Të krijojnë tinguj të *ulët - të lartë, të fortë- të butë, të gjatë – të shkurtër*.
17. Të zhvillojnë ndjenjën ritmike përmes *fjalive* me *fjalë 2-3-4 rrokësh, në muzikë* dhe në *mjedis*.
18. Të zhvillojnë modele ritmike të marra nga fjalitë, nga muzika apo mjedisi.
19. Të eksperimentojnë me *zë* dhe *instrument*, duke krijuar dhe imituar.
20. Të dallojnë *zërin që flet* dhe *zërin që këndon*.
21. Të dallojnë ndryshimet midis *zërave të tij/saj* dhe *zërave të tjerë*.
22. Të dallojnë ndryshimet e tingujve, p.sh. *midis instrumenteve*.
23. Të zbatojnë karakterin *shpejt – ngadalë* në këngë apo lojëra muzikore.
24. Të këndojnë këngë të thjeshta për fëmijë, me tematikë të ndryshme: *nga shoqëria, natyra, familja, kopshti etj*.
25. Të luajnë dhe këndojnë lojëra të ndryshme muzikore.
26. Të dëgjojnë muzikë të krahinave të ndryshme, duke treguar se ka disa lloje muzike.
27. Të dëgjojnë muzikë me dëshirë. Pjesëve muzikore që dëgjojnë, t’u përgjigjen në *mënyrë verbale* ose *joverbale* (p.sh. me lëvizje trupore ose vizatime të ndryshme).
28. Të përdorin *mjete, materiale* dhe *teknika* të ndryshme gjatë punëve të tyre.
29. Të përzgjedhin materialet e duhura të artit dhe mjetet që u duhen.
30. Të shpjegojnë kuptimin e fjalëve: *vija, ngjyra, forma*.
31. Të përcaktojnë *lloje të ndryshme vijash* në mjedisin që i rrethon dhe në punët e tyre të artit.
32. Të përcaktojnë ngjyrat: *të ngrohta (kuqe, verdhë, portokalli), të ftohta (blu, jeshile, lejla)*, në mjedisin që i rrethon dhe në punët e tyre të artit.
33. Të përcaktojnë disa *forma* (gjeometrike dhe natyrore) në mjedisin që i rrethon apo në punët e tyre të artit.
34. Të krijojnë modele të ndryshme me *plastelinë*.
35. Të kërkojnë për *modele* në mjedisin që i rrethon apo në punët e tyre të artit.
36. Të diskutojnë punët e artit - të vetat apo ato që shohin në libra ilustrues.
37. Të shpjegojnë punët e tyre të artit, por dhe ato të të tjerëve.
38. Të përshkruajnë disa lloje të artit figurativ.
39. T’i shpjegojnë punët (krijimet) me dëshirë dhe kuriozitet.
40. Të reflektojnë mbi punët e veta dhe të të tjerëve.

41. Të diskutojnë për artin figurativ në komunitetin e tyre.

Gjatë vallëzimit:

1. Të zhvillojnë në mënyrë të vetëdijshme veprimet që lidhen me *trupin, hapësirën dhe lëvizjet e vallëzimit*.
2. Të vallëzojnë duke zbatuar gjatë kërcimit një shumëllojshmëri dinamikash, si p.sh: *shumë shpejt, shumë ngadalë etj.*
3. Të kërcejnë duke mbajtur saktë kohën (p.sh përmes goditjeve me shuplaka).
4. Të kontrollojnë hapësirën që u duhet për të vallëzuar.
5. Të vallëzojnë duke zbatuar termat: *afër, larg, përmes, në mes, në qendër, mbrapa, nën, mbi, brenda, rreth e qark, udhëheqës, ndjekës.*
6. Të demonstrojnë lëvizje të ndryshme, qoftë edhe të kopjuara.
7. Të shprehin përmes kërcimit *imagjinatën dhe ndjenjat etj.*
8. Të improvizojnë *modele* të ndryshme kërcimi, si: *bashkëkohore, popullore etj.*
9. Të shpjegojnë vallëzime të ndryshme me dëshirë dhe kuriozitet.
10. Të reflektojnë rreth vallëzimeve të ndryshme që kërcejnë apo shikojnë.
11. Të zbulojnë lidhjet e vallëzimit me arte të tjera, si: *dramën, muzikën, artin figurativ etj.*

### **Edukimi fizik dhe shëndetësor**

Fëmija të jetë i aftë të:

1. Të lëvizë lirshëm me kënaqësi dhe vetëbesim gjatë lojërave dhe në mjedisin ku jeton.
2. Të kryejë lloje të ndryshme veprimesh, si: vrapim, kërcim rrëshqitje, zgjatje, rrotullim etj.
3. Të kontrollojë shpejtësinë e lëvizjes dhe ndryshimin e drejtimit.
4. Të orientohet në hapësirën kur luan.
5. Të koordinojë mirë lëvizjet dhe pozicionet e ndryshme gjatë lëvizjes.
6. Të ulet, të ngrihet dhe të balancohet me pjesët e ndryshme të trupit.
7. Të vetëkontrollohet në një pozicion fiks.
8. Të formojë shkathtësi në aspektin e zbulimit të vetvetes.
9. Të bashkëpunojë me shokët në ndarjen e detyrave.
10. Të kryejë praktikat higjieno-sanitare gjatë ngrënies dhe fjetjes.
11. Të zbatojë rregullat e domosdoshme për kujdesin shëndetësor.
12. Të tregojë rritje të kontrollit gjatë përdorimit të pajisjeve dhe konstruksioneve.
13. Të ndërtojë objekte me konstruksione të mëdha.
14. Të demonstrojë rritjen e aftësive dhe kontrollin në përdorimin e mjeteve të vizatimit dhe shkrimit, si dhe në lojëra të ndryshme.
15. Të mirëmbajnë mjetet dhe materialet që kanë në përdorim.

### **PRIORITET**

- **Gjuhë**

Komunikimi shokët ,edukatoren prindërit .Përdorimi pa kufi i fjalëve magjike .Përdorimi i kohëve të duhura të foljeve .Ritregimi i ngjarjes me sa më shumë detaje .

- **Matematika**

Të përdorë procedime numerike ,të përvetësojë veprime me mbledhje e zbritje me 1e 2njësi.Të realizojë bashkësi sendesh sipas vetive të tyre.Të njohë format gjeometrike ,të krahasojë dhe të rendisë sendet sipas madhësisë së tyre .Të dallojë ngjyrat kryesore .

• **VIZATËM**

Të mbajë në mënyrë korrekte stilolapsin dhe shkumësin .Të kopjojë dhe riprodhojë modele të dhëna nga edukatorja .Të shkruajë në vijë të drejtë .

Të ketë njohuri elementare për botën shtazore ,bimore.Të vëzhgojë vetitë e sendeve dhe ndryshimet në pasqyrë.

Do të siguroj bazën materiale që ndihmon në zhvillimin e të menduarit të fëmijëve ,do të zgjedhin botime të letërsisë që fëmijët të jenë motivuar në aktivitetin e Lexim –Shkrim.

**MUAJË SHTATOR**

JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
1	7/09	E HENE	Mirëse erdhët fëmijë të dashur	
	8	E MARTE	Njohja me ambjentin e grupit ,shokët ,edukatoren	
	9	E MERKURE	Rregullat e kopshtit	
	10	E ENJTE	Mjetet e mia	
	11	E PREMTE	Tregimi i "5 motrat bletë"	
2	14	E HENE	Zbatimi i regjimit ditor	
	15	E MARTE	Une i dua dhe i respektoj shoket e mij.	
	16	E MERKURE	Argetohemi e mesojme nepermjet lojes.	
	17	E ENJTE	Jemi yje te vegjel	<b>LITTLE STARS 1</b>
	18	E PREMTE	Tregimi "Qyteti i rratheve".	
	21	E HENE	Pergatisim rregullat ne klase	
	22	E MARTE	Llojet e vijave dhe simboleve.	
	23	E MERKURE	Klasifikojme te njejta e te ndryshme	
	24	E ENJTE	Tregimi "Kotelja e vogel ne kopesht"	

	25	E PREMTE	Te duam punen.	
4	28	E HENE	Bashkebisedojme dhe respektojme njeri tjetrin.	
	29	E MARTE	Kafshet jane te dobishme	
	30	E MERKURE	Kujdesi per veten.	
	1/10	E ENJTE	Libri miku im me i mire.	
	2/10	E PREMTE	Koncepti i nr 1	

<b><u>MUAJI TETOR</u></b>				
JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
5	5/10	E HENE	Gjuha e kafsheve	
	6	E MARTE	"Krimbi dhe molla" Tregim	
	7	E MERKURE	Me pelqen te vizatoj dhe te ngjyros bukur	
	8	E ENJTE	Mesojme dhe pershkruajme duke folur bukur	
	9	E PREMTE	Sa shume gjera mesoj ne kopshtin tim	
6	12	E HENE	Te kuptojne ndjenjat nepermjet gjesteve e mimikes.	
	13	E MARTE	Provojme te eksperimentojme me ngjyra	
	14	E MERKURE	Une di te zgjith situata	
	15	E ENJTE	Spostim dt 21 Sht e hene Perg.rreg e klases shiko	
	16	E PREMTE	Cdo njeri ka nje trup	
7	19	E HENE	Pushim	NENE TEREZA
	20	E MARTE	Shqisat tona koncepti nr 3	

	21	E MERKURE	Fytyra dhe ndjenjat	
	22	E ENJTE	Cfare me lumturon mua?	
	23	E PREMTE	Degjoni endrren time...	
8	26	E HENE	Koncepti shume pak	
	27	E MARTE	Vjeshta ka trokitur	ESKURSION NE NATYRE
	28	E MERKURE	Lejleket shtegtojne	
	29	E ENJTE	Une jam i rritur di te kujdesem per veten	
	30/10	E PREMTE	Gjethet ne vjeshte	

## **MUAJI NENTOR**

JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
9	2/11	E HENE	Edhe une dua te behem lider	
	3	E MARTE	Mysafiri ka vend te vecante	
	4	E MERKURE	Kujdesi per syte	
	5	E ENJTE	Kam deshire te vishem bukur	
	6	E PREMTE	Mos u sill me tjetrin ashtu si zdo deshe te silleshin me ty	
10	9	E HENE	Te imitojne zerat e kafsheve	
	10	E MARTE	Kujdesi per veten	
	11	E MERKURE	Mesojme duke provuar	
	12	E ENJTE	Endrrat e mia	

	13	E PREMTE	Femijet dhe kafshet kane ndjenja dhe familje	LITTLE STARS BOOK 3
11	16	E HENE	Te gjithë kemi pergjegjesi	
	17	E MARTE	Ushtari I vogel jam	
	18	E MERKURE	Une fal dhe te kerkoj falje	
	19	E ENJTE	Shtepia ime	
	20	E PREMTE	Une tregoj kujdes ndaj me te vegjelve dhe te moshuarve	
12	23	E HENE	Miniprojekt vjeshta	
	24	E MARTE	Festa e flamurit po afron	
	25	E MERKURE	Çlirimi I Atdheut	
	26	E ENJTE	Vizite ne muze	
	27/11	E PREMTE	PUSHIM KURBAN BAJRAMI	

## **MUAJI DHJETOR**

JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
13	30/11	E HENE		
	1/12	E MARTE	Dimri erdhi	
	2	E MERKURE	Bejme njeriun prej bore	
	3	E ENJTE	Shtepia ime	
	4	E PREMTE	Une tregoj kujdes ndaj me te vegjelve dhe te moshuarve	
14	7	E HENE	Thesari eshte familja	
	8	E MARTE	Me familjen kaloj çaste te lumtura	
	9	E MERKURE	Kujdesi ndaj paisjeve elektro-shtepiake	

	10	E ENJTE	"Gjuetiva e ngjyrave"	
	11	E PREMTE	Me pelqen te ndertoj vete lodrat e mia	
15	14	E HENE	Nuancat e ngjyrave dhe paraqitja e trekendorit	
	15	E MARTE	Ne dime te perdorim kur fjalet e mirsjelljes	
	16	E MERKURE	Rregulat ne te ushqyer dhe higjjena vetjake	
	17	E ENJTE	luajme se bashku Ndhimojme nj-tj	
	18	E PREMTE	Stinet e vitit Gjejme vendodhjen e sendeve :lart poshte	
16	21	E HENE	Eshte bukur kur ndan gjerat me te tjert	
	22	E MARTE	Sporti dhe gjimnastika ne shendetin tone	
	23	E MERKURE	Paraqitja e katrorit . Higjjena e gojes	
	24	E ENJTE	Doktori dhe shendetin yne	
	25	E PREMTE	pushim	Krishtlindje

## **MUAJI JANAR**

<b>JAVA</b>	<b>DATA</b>	<b>DITET</b>	<b>TEMA DITORE</b>	<b>SHENIME</b>
17	28/12	E HENE	Trekendori, rrethori, katrori	
	29	E MARTE	Mesojme te kunderten e fjales	
	30	E MERKURE	Pergatitemi per fasten e fundvitit	
	31	E ENJTE	Viti iri erdhi	
	1/1/2010	E PREMTE	pushim	Viti iri
18	4	E HENE	Drita ne jeten tone, element I rendesishem	
	5	E MARTE	Sa bukur kur merr dhe jep dhurata	
	6	E MERKURE	Koncepti I nr 6	

	7	E ENJTE	Qeni kafshe besnike	
	8	E PREMTE	Luajme mesojme zbavitemi	
19	11	E HENE	Dita e lodrave	
	12	E MARTE	Dallojme tingujt te ndryshem	
	13	E MERKURE	Tregimi : "Kenget e zogjve ".Lulja e blirit	
	14	E ENJTE	Galaktika Planetet dhe Yjet	
	15	E PREMTE	Toka rrotullohet rreth diellit dhe vetes	
20	18	E HENE	Te mesojme dhe te zbavitemi duke luajtur	
	19	E MARTE	Endrrat dhe ndjenjat tona	
	20	E MERKURE	Pa dielle nuk ka jete	
	21	E ENJTE	Biseda per henen dhe format e saj	
	22	E PREMTE	Koncepti I Numerorit shtate(7)	
21	25	E HENE	Te mbajme higjene e pasterti	
	26	E MARTE	Ndjenjat tona	
	27	E MERKURE	Frutat dhe perimet e stines	
	28	E ENJTE	Ajri dhe rendesia e tij	
	29/01	E PREMTE	Ajri dhe vetite e tij	

## **MUAJI SHKURT**

JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
22	01/02	E HENE	Pa uje nuk ka jete	
	2	E MARTE	Dukurite Natyrore	
	3	E MERKURE	Bora si dukuri natyrore	
	4	E ENJTE	Te dime si te sillemi	

	5	E PREMTE	Njohja dhe percaktimi I ngjyrave	
23	8	E HENE	Toka dhe gjallesat e saj	
	9	E MARTE	Dita dhe nata	
	10	E MERKURE	Stina e pranveres dhe karakteristikat e saj	
	11	E ENJTE	Natyra ne pranvere	
	12	E PREMTE	"Macja" Si te kujdesemi per kafshet	
24	15	E HENE	Veshjet sipas stineve	
	16	E MARTE	Te duam dhe te ndihmojme njeri tjetrin	
	17	E MERKURE	Dite me shi	
	18	E ENJTE	Vlerat ushqyese te frutave dhe perimeve	
	19	E PREMTE	Profesionet	
25	22	E HENE	Lulet dhe ngjyrat e pranveres	
	23	E MARTE	Aromat dhe ngjyrat e luleve	
	24	E MERKURE	Dritherat dhe rendesia e tyre	
	25	E ENJTE	(Vlerat) Nje dite pazari tek tregu I frutave dhe perimeve	
	26	E PREMTE	Koncepti I numerit 9	

## **MUAJI MARS**

JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
26	01/03	E HENE	Frutat dhe lengjet si domosdoshmeri jetike	
	2	E MARTE	Stilimi I veshjeve	
	3	E MERKURE	Ne park femijet ndjehen mire	

	4	E ENJTE	Pemet jane shume te dobishme	
	5	E PREMTE	Lulet dhe mjedisi	
27	8	E HENE	Festa e nenes dhe mesuesit	
	9	E MARTE	Koncepti ne kohe dhe me vendndodhjen (para,pas)	
	10	E MERKURE	Ngjart shprehin ndjenjat	
	11	E ENJTE	Karakteristikat e stines se pranveres	
	12	E PREMTE	Njohuri per kafshet dhe dallimi nepermjet tyre	
28	15	E HENE	Mirese erdhe dallendyshe	
	16	E MARTE	Bisede per kafshet e ujit,te egra,te buta	
	17	E MERKURE	Balona ime fluturon me lart	
	18	E ENJTE	Ku e kane shtepine kafshet	
	19	E PREMTE	Kafshet jane shume te dobishme per ne	
29	22	E HENE	Bleta dhe rendesia e saj	
	23	E MARTE	PUSHIM	
	24	E MERKURE	Kafshet e egra	
	25	E ENJTE	Me se ushqehen kafshet	
	26	E PREMTE	Ku e ka shtepine breshka	

### **MUAJI PRILL**

JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
30	29/03	E HENE	Te duam te mbrojme kafshet	
	30/03	E MARTE	Vizite ne parkun e shpendeve	

	<b>31/03</b>	E MERKURE	Fluturat shumengjyreshe	
	<b>01/04</b>	E ENJTE	Kafshet e ujit	
	<b>02</b>	E PREMTE	Edhe nentoke ka gjallesa	
<b>31</b>	<b>5</b>	E HENE	Klasifikimi I kafsheve	
	<b>6</b>	E MARTE	Shtepia e kafsheve	
	<b>7</b>	E MERKURE	Kafshet levizin ne menyre te ndryshme	
	<b>8</b>	E ENJTE	Te gjithë duhet te jetojne ne nje bote te paster	
	<b>9</b>	E PREMTE	Mjetet e komunikacionit	
<b>32</b>	<b>12</b>	E HENE	Telefoni,televizori mjete komunikimi	
	<b>13</b>	E MARTE	Kompjuteri mjet I domosdoshem	
	<b>14</b>	E MERKURE	Perdorimi dhe rendesia e telefonit	
	<b>15</b>	E ENJTE	Miku im libri	
	<b>16</b>	E PREMTE	Si eshte moti ne vendin tone	
<b>33</b>	<b>19</b>	E HENE	Karakteristikat e stinesse veres	
	<b>20</b>	E MARTE	Frutat dhe perimet e stines se veres	
	<b>21</b>	E MERKURE	Mua me pelqejne frutat dhe perimet	
	<b>22</b>	E ENJTE	Ne piknik:(Afer liqenit artificial)	
	<b>23</b>	E PREMTE	Bisede :Per udhetimet (toke,det,ajer)	
<b>34</b>	<b>26</b>	E HENE	ZJARRFIKESËT	
	<b>27</b>	E MARTE	Automjetet e punes	
	<b>28</b>	E MERKURE	Loja na ben te lumtur	
	<b>29</b>	E ENJTE	Une udhetoj me tren dhe bicikle	
	<b>30</b>	E PREMTE	Mjetet e transportit detar	

**MUAJË MAJ**

<b>JAVA</b>	<b>DATA</b>	<b>DITET</b>	<b>TEMA DITORE</b>	<b>SHENIME</b>
<b>35</b>	<b>03/05</b>	E HENE	Festa e 1 Majit	
	<b>4</b>	E MARTE	MJETET E FLUTURIMIT	
	<b>5</b>	E MERKURE	PROFESIONET (Makinist,treni,pilot)	
	<b>6</b>	E ENJTE	Vjelja e frutave	
	<b>7</b>	E PREMTE	Me çfare mjeti ju pelqen te udhetoni per pushime	
<b>36</b>	<b>10</b>	E HENE	Sa me pelqejne akulloret	
	<b>11</b>	E MARTE	Rregullat e sjelljes	
	<b>12</b>	E MERKURE	Nje ambjent I bukur	
	<b>13</b>	E ENJTE	Punet ne familje	
	<b>14</b>	E PREMTE	Kush me ben mua te lumtur	
<b>37</b>	<b>17</b>	E HENE	Ariu ,ketri,dhelpra,ujku.	
	<b>18</b>	E MARTE	Përrallë në vargje	
	<b>19</b>	E MERKURE	Ekskursion	
	<b>20</b>	E ENJTE	Album (kafshët e egra)	
	<b>21</b>	E PREMTE	Matematikë	
<b>38</b>	<b>24</b>	E HENE	Bisedë 1 Qershori (festa)	
	<b>25</b>	E MARTE	Vjershë 1Qershori	
	<b>26</b>	E MERKURE	Përgatitja për ekspozitën	
	<b>27</b>	E ENJTE	Këngë Erdhi 1 qershori	
	<b>28</b>	E PREMTE	Përgatitja e konvertit	

## MUAJI QERSHOR

JAVA	DATA	DITET	TEMA DITORE	SHENIME
39	31/05	E HENE	Festojmë së bashku 1 Qershorin	
	01/06	E MARTE	Së bashku prindër e fëmijë shohin ekspozitën	
	2	E MERKURE	Lojra Popullore.	
	3	E ENJTE	Lojramuzikore	
	4	E PREMTE		
40	7	E HENE	Ku do të shkojmë pas kopshtit ?	
	8	E MARTE	Vizitë në klasën e parë	
	9	E MERKURE	Ekskursion	
	10	E ENJTE	Njohja me abetaren e matematikën.	
	11	E PREMTE	Festa e lamtumires	
41	12	E HENE		
	13	E MARTE		
		E MERKURE		
		E ENJTE		
		E PREMTE		
42		E HENE		
		E MARTE		
		E MERKURE		
		E ENJTE		
		E PREMTE		

MESUESE

NENDERJTORI  
 Shpresa Kambellari

DREJTORI  
 NEVZAT YILDIRIM